

PËR MË SHUMË INFORMACION

Drejtor i Programit: Luigi D'Angelo
email : Luigi.DAngelo@protezionecivile.it
tel. +39 06 68 20 29 11

Sekretariati Teknik:

Presidenca e Këshillit të Ministrave
Departamenti Italian i Mbrojtjes Civile
Via Ulpiano n.11
00193 Roma
Email: pronews@protezionecivile.it
tel. +39 06 68202030

DREJTUESI I KONSORCIUMIT

Departamenti Italian i Mbrojtjes Civile (DPC), Itali

PARTNERËT E PROGRAMIT

Fondacioni Kërkimor CIMA (CIMA), Savona (Itali) dhe Tiranë (Shqipëri)
Qendra Evropiane për Parashikimin e Motit afat-mesëm (ECMWF), Reading (Mbretëria e Bashkuar)
Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri, Tiranë (Shqipëri)
Shërbimi Meteorologjik dhe Hidrologjik i Kroacisë (DHMZ), Zagreb (Kroaci)
Organizata Botërore e Meteorologjisë (WMO), Gjenevë (Zvicër)

PARTNERË TË TJERË

Rajoni Emilia Romagna (Arpa) - Itali
GIZ Shqipëri



www.pronewsprogramme.eu



Ky dokument është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm e programit PRO NEWS dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Bashkimit Evropian.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



PRO NEWS

Programi për Përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe parandalimin e përmbytjeve në Shqipëri



Një program që zbatohet nga:



Kohëzgjatja: Janar 2017 - Nëntor 2018 (22 muaj)

Vendndodhja: Shqipëri

Buxheti i programit: 2.281.404 EURO

QËLLIMI I PROGRAMIT

Objektivi i përgjithshëm i PRO NEWS është të rrisë aftësinë ripërtëritëse ndaj përmbytyjeve duke forcuar Sistemin Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm në Shqipëri dhe duke përmirësuar parandalimin e fatkeqësive në përputhje me Praktikën e Mira të Bashkimit Evropian.

Objektivi i veçantë është të forcojë më tej kapacitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile në Shqipëri, për të parandaluar dhe për t'u përgjigjur në kohë në menaxhimin e fatkeqësive.

PËRFITUESIT DHE PARTNERËT E PROGRAMIT

Ministria e Punëve të Brendshme të Shqipërisë

Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile (DPEC)

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM)

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rual dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU)

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)
Sekretariat Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU)

FUSHA TEMATIKE

Gadishmëria në mbrojtjen civile dhe zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë

Përfaqja e PRO NEWS

- Të sigurojë pjesëmarrjen aktive të aktorëve lokalë në të gjitha nivelet (kombëtare dhe lokale).
- Të sigurojë përdorimin e burimeve ekzistuese, të kapaciteteve dhe të rrjeteve të krijuara në fushën e Paralajmërimit të Hershëm, të Menaxhimit të Përmbytyjeve dhe të Mbrojtjes Civile.
- Të sigurojë përdorimin e kapaciteteve ekzistuese të Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm (nga parashikimi në planifikimin dhe menaxhimin e përmbytyjeve), si dhe komunikimin dhe bashkëpunimin ndërinstytucional lidhur me menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë.
- Të nxisë përdorimin e praktikave të mira në fushën e menaxhimit të riskut nga përmbytyjet, në nivel kombëtar, rajonal dhe të Bashkimit Evropian.

Për të arritur qëllimin e Programit, janë konceptuar gjashtë paketa të ndërlydhura pune:

1. Mbështetje për Zhvillimin Ligjor dhe Institucional për përmirësimin e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm, Menaxhimit të Përmbytyjeve dhe mbrojtjen civile, përmes vlerësimit të kuadrit aktual ligjor dhe institucional dhe përmes forcimit të kapaciteteve të autoriteteve kombëtare dhe vendore për të zhvilluar planet e Mbrojtjes Civile duke përdorur qasjen me pjesëmarrje.
2. Mbështetje për krijimin e një harte për rrezikun nga përmbytyjet, duke ndjekur Direktivën e BE-së për Përmbytyjet, nëpërmjet mbështetjes teknike dhe trajnimit për përgatitjen dhe përdorimin e hartave të detajuara të Rrezikut nga Përmbytyjet.
3. Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Parashikimit dhe të Paralajmërimit për Përmbytyjet dhe përfshirjen e tij në Sistemin Evropian të Ndërgjegjësimit për Përmbytyjet, duke zhvilluar një model operacional hidrologjik për të gjithë vendin, përfshirë dhe basenin e lumenjve ndërkufitarë, për paralajmërimin e hershëm, modernizimin e infrastrukturës meteorologjike dhe përmirësimin e rrjetit të teknologjisë së informacionit (IT).
4. Konceptimi i një fushate kombëtare për ndërgjegjësimin publik, bazuar në praktikën e mira të BE-së për mbrojtjen kombëtare civile, me qëllim përmirësimin e njohurive dhe të rritjes së ndërgjegjes të grupeve përkatëse të synuara mbi aftësitë ripërtëritëse.
5. Mbështetje për Shqipërinë në përgatitjen për anëtarësim në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian nëpërmjet seminareve, trajnimeve për Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së dhe shkëmbimit të ekspertëve.
6. Mbështetje e programit përmes mbikëqyrjes, koordinimit dhe monitorimit në bazë të rezultateve.

REZULTATET E PRITSHME

1. Përmirësimi i Kuadrit Ligjor dhe Institucional lidhur me Paralajmërimin e Hershëm, Menaxhimin e Përmbytyjeve dhe Mbrojtjen Civile.
2. Krijimi i Hartave të Rrezikut nga Përmbytyjet, sipas dispozitave të Direktivës së BE-së për Përmbytyjet.
3. Përmirësimi i Paralajmërimit të Hershëm të Përmbytyjeve dhe përfshirja në Sistemin Evropian të Ndërgjegjësimit të Përmbytyjeve.
4. Promovimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit dhe të nxitjes tek popullata e sjelljes së duhur në rast emergjence.
5. Ndhimesë për institucionet shqiptare për t'u përfshirë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian.

PRO NEWS do të fillojë me një analizë fillestare që synon të kuptojë gjendjen aktuale në lidhje me hartëzimin e riskut, Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm dhe kuadrin ligjor kombëtar mbi mbrojtjen civile dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në shkallë të gjerë.

Sduti i dokumentave dhe misionet për mblehdjen e fakteve do të zhvillohen me Ekspertët e Programit dhe anëtarët e Konzorciumit në bashkëpunim të ngushtë me institucionet kryesore të përfshira në mënyrë që të kuptojnë rrjetin e grupeve të synuara të interesuara në komponentët e Programit.

Faza fillestare do të rezultojë në miratimin e planit të punës dhe një përkufizim më të mirë të aktiviteteve që do të kryhen gjatë zbatimit të Programit.

Asistenca teknike dhe aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve, duke përfshirë trajnimin, punëtoritë dhe misionet këshilluese do të përdoren për arritjen e rezultateve të pritshme. Aktivitetet e Programit do të shpërndahen përmes platformave online, mediave dhe veprimtarive të ndryshme.